



Prishtinë: 23.06.2016  
Kodi i ZRRE-së: V\_827\_2016

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_1465\_03\_16**;
- Ankesa e konsumatorit e datës **27.05.2016**.

### në seancën e mbajtur më datë 23 qershor 2016, nxori këtë:

#### V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit H. T. me shifër DPR – 110196 ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II **Mbetet në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK\_V\_1485\_05\_16** i datës 13.05.2016.

#### A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 27.05.2016 ka pranuar ankesën e parashtruar nga konsumatori H. T. i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE për këto shkaqe: Konsumatori ka kërkuar që vendimi i atakuar të rishikohet edhe njëherë, e këtë e bazon në faktin se nuk pajtohet me nxjerrjen e mesatares kohore prej prej 672 kWh, pasi që me këtë mesatare nuk përputhen shpenzimet e dy muajve kontestues, konsumatori gjithashtu thekson se jam familje 4 anëtarshë, nxehjen e kam përmes nxehjes me dru dhe thëngjill dhe se këto shpenzime janë të larta në krahasim me shpenzimin. Pika tjetër e kundërshtimit është se konsumatori nuk i beson laboratorit të kalibrimit në punën e tyre pasi që ky laborator e ka paditë në gjykatë, andaj nuk mund t'i besoj pasi që ky laborator sipas konsumatorit mund të jetë i një anshëm në konstatimin e tij.

Departamenti i faturimit në KESCO me datë 21.02.2015 i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike për periudhën shkurt 2015 me shpenzim prej **2,507 kWh** apo e shprehur në vlerë financiare **247.95€**, kurse me datë 23.03.2013 i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike për periudhën mars 2015 me shpenzim prej **1,218 kWh** apo e shprehur në vlerë financiare **110.99€**.

Me datë 27.03.2015 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KESCO duke kundërshtuar faturimin për shkak të leximit dhe faturimit jo të saktë, si dhe matjes jo të saktë të njehsorit elektrik.



Me datë 23.05.2015 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit dhe gjatë inspektimit kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve të regjistruara në njehsorin elektrik nr.16077027, e cila gjendje në momentin e inspektimit ka qenë TL=000494 kWh (tarifa e lartë) dhe TU=000167 kWh (tarifa e ulët). Gjithashtu në procesverbal punëtorët e autorizuar të KEDS-it kanë theksuar se njehsori është ndërruar.

Me datë 30.06.2015 Departamenti për Konsumator në KESCO i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e tij bazuar në pasqyrën e rrjedhës së energjisë elektrike si dhe procesverbalin e inspektimit nr. 0734589 datë 23.05.2015. Gjithashtu është theksuar se faturimi është bërë konform rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji.

I pakënaqur me përgjigjen e KESCO-s konsumatori me datë 07.07.2015 ka parashtruar ankesë në DMK të ZRRE-së duke kundërshtuar përgjigjen e KESCO-s, si dhe kërkuar që të bëhet shqyrtimi i faturave për periudhat shkurt dhe mars 2015. Konsumatori në ankesën e tij ka theksuar se nuk ngrohet me energji elektrike, por që në sezonin e dimrit përdor dru dhe thëngjill. Konsumatori ka kërkuar të krahasohen shpenzimet e muajve paraprak me harxhimet e kontestuar, e të cilat janë shumëfish më të larta.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 23.06.2016 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga ana e konsumatorit H. T. dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i ZRRE-së pas analizimit të shkresave të lëndës dhe vendimit të DMK-së ka vërejtur se organi i shkallës së parë DMK me të drejtë ka vërtetuar faktin se bazuar në protokollin mbi shqyrtimin e njehsorit elektrik nr. 8196063 konstatohet se njehsori elektrik ka bërë matje të saktë të shpenzimeve të energjisë elektrike dhe është brenda kufijve të lejuar të gabimit pasi që është në përputhje me kufirin e pasaktësisë të përcaktuar me kodin e matjes.

Bordi i ZRRE-së pasi analizoj pikën e kundërshtimit të theksuar në ankesë lidhur me mesataren e shpenzimit të energjisë ka konstatuar se konsumatori ka lexim dhe faturim të rregullt të shpenzimeve të energjisë elektrike, përveç periudhës janar 2015. Krahasimi i shpenzimeve për periudhën kontestuese me periudhat e njëjta kohore më të hershme dhe me të vonshme vërteton se konsumatori ka luhatur në shpenzimin e energjisë përkatësisht në periudhën kontestuese ka rritje të shpenzimit. Bazuar në shpenzimet e regjistruara dhe faturuara për periudhën kontestuese të konsumatorit shkurt dhe mars 2015, Bordi gjithashtu ka vlerësuar si të drejtë konstatimin nga DMK-së konsumatori është faturuar pa matje, përkundrazi është faturuar me shpenzimet reale e që vërtetohen edhe me procesverbalin e ndërrimit dhe heqjes së njehsorit elektrik nr.0159762 të datës 22.04.2015, si dhe listave të leximit. Kjo për me tepër vërtetohet me krahasimin të shpenzimeve të konsumatorit për periudhat e njëjta si: periudha **02/2014** është **436 kWh**, periudha **03/2014** është **436 kWh**, periudha **02/2013** është **741 kWh** si dhe periudha **03/2013** është **654 kWh**, kurse me njehsorin e ri elektrik nr. 16077027 periudha **02/2016** është **554 kWh** dhe periudha **03/2016** është **603 kWh**. Për me tepër duhet theksuar se mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike të njehsorit elektrik të vjetër nr. 08196063 prej periudhës 02/2010 e deri më 28.04.2015 ka qenë **554.41 kWh/muaj**, ndërsa mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike të njehsorit elektrik të ri nr. 16077027 prej periudhës 04/2016 e deri më 05/2015 është **671.67 kWh/muaj**. Andaj mbi këtë bazë Bordi ka konstatuar se nuk qëndrojnë argumentet e konsumatorit se nxjerrja e mesatares prej 672 kWh është në kundërshtim me shpenzimet reale që ka konsumatori në këtë pikë matëse.

Sa i përket konstatimeve të theksuara në ankesë lidhur me laboratorin e kalibrimit Bordi ka konstatuar se është e rëndësishme që ky institucion është duke kryer punën në mënyrë profesionale



gjë për të cilën nuk ka shpreh dilema as vetë konsumatori në ankesën e tij, por që sa i përket çështjes se inicimit të padisë në gjykatë kjo çështje nuk është objekt shqyrtimi në ZRRE dhe si e tillë edhe nuk mund të shqyrtohet pasi që është kompetencë e gjykatave.

Bordi ka konstatuar se organi i shkallës së parë ka vërtetuar gjendjen faktike në menyrë të drejtë dhe të plotë pasi që janë analizuar në detaje rrjedhat e energjisë elektrike për këtë pikë matëse dhe të gjitha procesverbalet tjera të lëshuara nga ana e KEDS/KESCO dhe mbi këtë bazë ka bërë korigjimin financiar të konsumatori duke respektuar saktë dispozitat ligjore në fuqi.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në rregulla dhe ligje.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 23.06.2016 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

#### **Bordi i ZRRE-së:**

---

Enver Halimi, kryesues

---

Krenar Bujupi, anëtar

---

Arsim Janova, anëtar

---

Qemajl Mustafa, anëtar

---

Besim Sejfiqaj, anëtar

#### **Vendimi iu dërgohet:**

- Konsumatorit H. T.
- KESCO-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.